

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtruesi: Mbrojtësi i Specializuar i Hashim Thaçit

Data: 2 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për shtim të numrit të lejuar të fjalëve

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Hashim Thaçit

Dejvid Hupër

Mbrojtësi i Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësi i Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtësi i Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagendra

I. HYRJE

1. Në pajtim me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës,¹ Mbrojtja e z. Hashim Thaçi ("Mbrojtja") kërkon një shtim të numrit të lejuar të fjalëve për të autorizuar dorëzimin e një kërkesë për lirim të përkohshëm të përbërë prej 8500 fjalësh. Mbrojtja parashtron se rrethanat e posaçme që e justifikojnë një rritje të tillë bazohen te rëndësia e objektit të kërkesës dhe vëllimi i materialeve të nevojshme për t'u trajtuar në të.
2. Kjo kërkesë parashtrohet si konfidenciale sepse përmend parashtrime konfidenciale dhe materiale të nxjerra konfidenciale, mirëpo Mbrojtja nuk është kundër riklasifikimit si publike.

II. PARASHTRIMET

3. Kërkesa për lirim të përkohshëm në pritje të fillimit të gjyqimit është një prej parashtrimeve më të rëndësishme që bën një ekip i mbrojtjes. Duke pasur parasysh problemin që ngrihet, që është liria e të akuzuarit, një kërkesë e tillë kërkon një arsyetim të hollësishëm dhe të përshtatshëm, si nga ana juridike, ashtu edhe nga ajo faktike.
4. Në këtë rast, argumentet e bëra nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") në kërkesën e saj për arrestimin dhe paraburgimin e z. Thaçi janë të gjerësishme dhe materiali ku mbështetet është voluminoz. Ndërkohë që kërkesa e parë materiale e

¹ Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-15, 17 maj 2019 ("Udhëzuesi i Punës").

ZPS-së arrin 6690 fjalë,² mbi numrin e lejuar prej 6000 fjalësh,³ materialet bazë jepen në tri shtojca dhe në paketën 7 të ZPS-së, me 35 dokumente (raporte, aktgjykime, deklarata të dëshmitarëve etj..) të vëna në dispozicion më 20 nëntor 2020. Krahas kësaj, çështjet e ngritura, si rreziku i pretenduar i arratisjes dhe ndërhyrjet ndaj dëshmitarëve, janë trajtuar më pas në disa parashtrime të tjera të protokolluara të cilave Mbrojtja mund t'u përgjigjet.⁴

5. Për t'u dhënë përgjigje siç duhet argumenteve dhe materialeve mbështetëse të ZPS-së, Mbrojtja kërkon shtim të numrit të lejuar prej 6000 fjalësh.

III. PËRFUNDIM

6. Për arsyet e lartpërmendura, Mbrojtja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake:

² KSC-BC-2020-06/F00005/CONF/RED, Version i redaktuar konfidencial i "Kërkesës për fletarrestime dhe urdhrave lidhur me to", parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005, datë 28 maj 2020, me shtojcën e redaktuar konfidenciale 1 dhe shtojcat konfidenciale 2 dhe 3, vendosur në dispozicion më 15 nëntor 2020.

³ Udhëzuesi i punës, neni 41.

⁴ KSC-BC-2020-06/F00020, Urdhër Prokurorit të Specializuar për parashtrime plotësuese, datë 12 tetor 2020, riklasifikuar si publik më 20 nëntor 2020; KSC-BC-2020-06/F00022/Conf/Red, Version i redaktuar konfidencial i "Parashtrimeve të Prokurorisë në pajtim me urdhrin KSC-BC2020-06-F00020", parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-06-F00022, datë 19 tetor 2020, vendosur në dispozicion më 18 nëntor 2020; KSC-BC-2020-06/F00027, Vendim konfidencial mbi kërkesën për fletarrestimet dhe urdhrat e transferimit, datë 26 tetor 2020, vendosur në dispozicion më 25 nëntor 2020; KSC-BC-2020-06/F00027/A01/RED, Version i redaktuar publik i fletarrestimit për Hashim Thaçin, datë 26 tetor 2020, vendosur në dispozicion më 5 nëntor 2020; KSC-BC-2020-06/F00028, Vendim konfidencial dhe *ex parte* për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit, datë 26 tetor 2020, vendosur në dispozicion më 25 nëntor 2020; KSC-BC-2020-06/F00094/CONF/RED, Version i redaktuar konfidencial i "Kërkesës për masa mbrojtëse", KSC-BC-2020-06/F00094/CONF/RED, datë 19 nëntor 2020, i vendosur në dispozicion më 24 nëntor 2020 me shtojcën konfidencial 13; KSC-BC-2020-06/F00102/CONF/RED, Version i redaktuar konfidencial i parashtrimit plotësues të kërkesës për masa mbrojtëse, me shtojcat e redaktuara konfidenciale 1 dhe 2, 26 nëntor 2020.

TË AUTORIZOJË shtimin e lartkërkuar të numrit të lejuar fjalëve në lidhje me
kërkesën për lirim të përkohshëm që do të parashtrojë Mbrojtja.

[Numri i fjalëve (në origjinal): 605]

Me respekt,

/nënshkrimi/

Dejvid Huper

Mbrojtës i Specializuar i Hashim Thaçit

E hënë, 2 dhjetor 2020

Stamboll, Turqi